



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2862 Prot

Lezhë, më 26 / 02 /2021

VENDIM

Nr 28, Datë 24 / 02 /2021

**PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME
TË TË ARDHURAVE PËR DY VITET PARA VITIT
BUXHETOR, VITIN BUXHETOR 2021 DHE TRE VITET
E ARDHSHME BUXHETORE 2022-2024**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, pas shqyrtimit të materialit të paraqitur nga Bashkia Lezhë dhe pas diskutimit të antarëve, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Lezhë, për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor 2021 dhe tre vitet e ardhshme buxhetore 2022-2024, sipas pasqyrave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

